



10 ✓

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 624/1 Prot.

Elbasan, më 28.02.2023

Lënda: Informim

Znj.Enia HOXHA

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 «Për Vetëqeverisjen Vendore», ligjit nr 119/2014, "Për Të Drejtën e Informimit" dhe duke u mbështetur shkresës suaj me nr:624 prot, datë 27.01.2023, ardhur pranë institucionit tonë më datë 01/02/2023, Ju informojmë se: Bashkia Elbasan për procesin e integritit europian bashkëpunon ngushtësisht me Projektin: Bashkitë për në Europë ku në platformën e tyre ju gjeni të gjithë të dhënat që lidhen me treguesit e performancës sipas programeve të ndërhyrjes.

Organizata të shoqërisë civile që operojnë në Bashkinë Elbasan janë 22 organizata, informacionin e gjeni në faqen e institucionit tonë: www.elbasani.gov.al.

Për të dhënat që ju kërkoni për koordinatorin/en për njoftimet dhe konsultimet publike ju informojmë se pranë Bashkisë Elbasan është ngritur një sektor: Sektori i Kordinimit të Politikave Strategjike dhe Konsultimit me Publikun. Lidhur me Koordinatorin për të drejtën e informimit në Bashkinë Elbasan është znj.Aida Talelli me email: aida.urupi@elbasani.gov.al dhe nr tel : 054 400 171.

Konsultimi për dëgjesat e hapura publike është realizuar sipas kalendarit të aktiviteteve, në çdo Lagje dhe Njësi Administrative të Bashkisë Elbasan. Përgatitja e kalendarit të dëgjesave publike është realizuar në bashkëpunim me Drejtuesit e Drejtorive të Bashkisë Elbasan, Administratorët e Njësive Administrative dhe Lagjeve, përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, Akademikëve të Universitetit: «Aleksandër Xhuvani», grupeve rinore etj.

Ju faleminderit për bashkëpunimin,

KRYETARI

Gledian LLATJA

Me Urdhër e Porosi

ZV/KRYETARE

Aulona Bylykbashi